



Breaking News: Tiranë – Kanosi gjatë ushtrimit të detyrës, një grup xhirimi, vihet në pranga 64-vjeçari



Lajmet

13/08/2026

Tiranë – Kanosi Gjatë Ushtrimit Të Detyrës, Një Grup Xhirimi, Vihet Në Pranga 64-Vjeçari

Ai u kap në një terren të thepisur, pak minuta pas kallëzimit të 3 shtetasve.

I arrestuari kryente punime pa leje te burimi i ujit, ku grupi i xhirimit do të realizonte kronikën.

Pardje, Policia e Tiranës inicioi procedim penal për shtetasin që kishte punësuar 64-vjeçarin, për shpërdorim të tokës, ndërtim të paligjshëm dhe shkatërrim të rrjetit të ujitjes.

Pas administrimit të menjëhershëm të kallëzimit të 3 shtetasve, me detyra përkatëse gazetar, operator dhe drejtues automjeti, në televizionin Ora News, se gjatë realizimit të një kronike mbi problematikat me një burim uji (pus) në fshatin Zbarqë, Tiranë, ishin kanosur për jetën, nga një shtetas që kryente punime te ky burim, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 6 arrestuan autorin e dyshuar të rastit, shtetasin S. I., 64 vjeç.

64-vjeçari u kap pak minuta pas kallëzimit të grupit të xhirimit, në zonën malore të fshatit Zbarqë.

Gjatë kontrollit të banesës së 64-vjeçarit, iu gjet dhe iu sekuestrua një armë gjahu pa leje, municion dhe një armë e ftohtë(shufër metalike).

Më datë 11.08.2026, shërbimet e Komisarariatit të Policisë Nr. 6 referuan materialet në Prokurori, ku nisi procedimi penal për shtetasin për llogari të të cilit punonte 64-vjeçari, R. P., 70 vjeç, banues në Tiranë, për veprat “Shpërdorimi i tokës”, “Ndërtimi i paligjshëm” dhe “Shkatërrimi i rrjetit të ujitjes”, pasi dyshohet se ka hapur një burim uji (pus), pa leje, si dhe se ka kryer gërmime në mënyrë të kundërligjshme, për hapjen e një rruge.

Materialet procedurale do t’i referohen Prokurorisë së Tiranës, për veprime të mëtejshme.

Policia e Tiranës garanton gazetarët dhe përfaqësuesit e medias, se është maksimalisht e angazhuar për të bashkëpunuar me ta, me qëllim trajtimin e menjëhershëm dhe prioritar, të çdo indicieje për cenim të së drejtës së tyre kushtetuese për të ushtruar detyrën në shërbim të interesit publik.



Tiranë - Kanosi gjatë ushtrimit të detyrës, një grup xhirimi, arrestol
Policia e Shtetit



Watch on

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital



Arkiva

Select Month



Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)